



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Elbasan më _____. ____2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS "Mbikqyrja e punimeve në disa objekte", i ndarë në lote, si mëposhtë:

Loti I : Mbikqyrje e objektit: "Rehabilitimi i shesheve të pallateve 83/1, të pallatit 107/2; të pallateve 586 dhe rrugës "Ramazan Sina", i shesheve të pallateve 587, 588, 688/1, i sheshit përpara pallateve 645/1, 645/3, 645/4, në lagjen Vullnetari, sistemim i rrugës "Petraq Popa" dhe sheshit para rajonit nr.2".

Loti II : Mbikqyrje e objektit: "Rehabilitim sheshit të pallateve 39, 42/4, 43, 44, 40, rehabilitim i sheshit të pallateve 496, sistemimi i rrugës "Lirak Dodbiba", i rrugës "Gani Daiu" dhe rrugës "Mustafa Bodini", sistemimi i rrugës "Qamil Xhaja", lagja "Syrja Dylgjeri", Rajoni nr.3"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 79714000-2 - Shërbime të mbikqyrjes

VLERA E FONDIT LIMIT: 848.882 (tetëqind e dyzet e tetemije e tetëqind e tetëdhjetë e dy) **lekë pa t.v.sh.**, i ndarë në lote, si mëposhtë:

"Mbikqyrja e punimeve në disa objekte", i ndarë në lote, si mëposhtë:

Loti I : Mbikqyrje e objektit: "Rehabilitimi i shesheve të pallateve 83/1, të pallatit 107/2; të pallateve 586 dhe rrugës "Ramazan Sina", i shesheve të pallateve 587, 588, 688/1, i sheshit përpara pallateve 645/1, 645/3, 645/4, në lagjen Vullnetari, sistemim i rrugës "Petraq Popa" dhe sheshit para rajonit nr.2". me fond limit 429,315 (katërqind e njëzet e nentemijë e treqind e pesëmbëdhjetë) **lekë pa t.v.sh.**

Loti II : Mbikqyrje e objektit: "Rehabilitim sheshit të pallateve 39, 42/4, 43, 44, 40, rehabilitim i sheshit të pallateve 496, sistemimi i rrugës "Lirak Dodbiba", i rrugës "Gani Daiu" dhe rrugës "Mustafa Bodini", sistemimi i rrugës "Qamil Xhaja", lagja "Syrja Dylgjeri", Rajoni nr.3" me fond limit 419.567 (katërqind e nëntëmbëdhjetemijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa t.v.sh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Shtojca 9.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

Loti I : Mbikqyrje e objektit: "Rehabilitimi i shesheve të pallateve 83/1, të pallatit 107/2; të pallateve 586 dhe rrugës "Ramazan Sina", i shesheve të pallateve 587, 588, 688/1, i sheshit përpara pallateve 645/1, 645/3, 645/4, në lagjen Vullnetari, sistemim i rrugës "Petraq Popa" dhe sheshit para rajonit nr.2". me fond limit 429,315 (katërqind e njëzet e nentemijë e treqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa t.v.sh.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë. bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 82 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar përcaktohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kriteri (1-b) është vendosur bazuar në nenin 83 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenin 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 83 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe piken 1 të nenit 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar përcaktohet: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9;

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar; të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

Në nenin 76, pika 2 të LPP parashikohet: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia.

Në nenin 2, germa ç, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet: Ky ligj zbatohet për:

ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Në nenin 4, pika 1 dhe 3, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore.

3. Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore.

Në neni 43 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.

1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkontë regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re

Në nenin 5 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:

a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesatvëndore, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;

b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori nënkategori të bazës së taksës;

c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore përgjate tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; si dhe ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore

mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ne nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjithatë ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Gjithashtu është kërkuar që vlera minimale e xhiros vjetore për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë, duke qenë se lloji i procedurës është e hapur e thjeshtuar, të jete jo më vogël se 40 % e fondit limit.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatore Ekonomik duhet të paraqesin:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Në nenin 77 pika 4 i LPP, ndër të tjera parashikohet se: Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Në nenin 41, pika 3 parashikohet se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në nenin 55 “Procedura e hapur e thjeshtuar”, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të

kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Sa me sipër është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale për realizimin e shërbimit, objekt i kontratës:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:

- **N.P - 1** Punime gërmimi në tokë
- **N.P - 4** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- **N.P - 7** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.
- **N.P – 11** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- **N.P – 12** Punime të inxhinierise te mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- **N.S - 1** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 6** Sinjalistika rrugore jondriçuese
- **N.S - 18** Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet ekuivalentimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne VKM nr 759, date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, si dhe ne VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në piken 1 të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

*Çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të pajiset me **licencën profesionale përkatëse** dhe të regjistrohet në regjistrat profesionale të subjekteve të licencuara në këto fusha, bazuar në rregulloren bashkëlidhur këtij vendimi.*

Në nenin 2, pika 2, të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Licencë profesionale” - Është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën, të fillojë e të ushtrojë profesionalisht veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, ose mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Në nenin 16, pika 1, të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.

Ne nenin 2, pika 2 të VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, parashikohet se:

Caktimin e mbikëqyrësit/grupit të mbikëqyrësve, zhvilluesi e kryen duke pasur parasysh llojin e punimeve që do të mbikëqyren në zbatimin e veprës. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve caktohet në bazë të licencës profesionale të mbikëqyrjes që disponon dhe pikëve të kualifikimit, të cilat përkojnë me zërat e punimeve që do të kryhen në objekt.

Ne nenin 3 të VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, parashikohet se:

Në rastet kur autoritetet publike investojnë dhe realizojnë një zhvillim në një zonë të caktuar, mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve përzgjidhet nga autoriteti publik në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni për prokurimin publik në fuqi.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve qe do realizohen sipas preventivit dhe projektit te zbatimit.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit, si mëposhtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Arkitekt	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Totograf	1 (një)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesiperm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne VKM nr 759, date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, si dhe ne VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

Në nenin 16, pika 1, të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.*
- 2. Kategorive e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, përfitohen mbështetur në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale sipas kushteve dhe kriterëve të specifikuar në këtë rregullore.*
- 3. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.*

Në nenin 22, pika 2, “Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale” të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.*
- 2. Kategorive e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, përfitohen mbështetur në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale sipas kushteve dhe kriterëve të specifikuar në këtë rregullore.*
- 3. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.*

Në nenin 23, pika 2, “Kushtet paraprake për drejtuesit teknikë të shoqërisë” të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim, është një, ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale në fushën respektive dhe me vite eksperience, jo më pak se 15 vjet. Individu mund të përfitojë licencën individuale, njëkohësisht, me vendosjen si drejtues teknik.

c) Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur dhe në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

ç) Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi, në dy ose më shumë shoqëri.

d) Drejtuesi/drejtuesit teknikë duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë, për një periudhë, jo më pak se një vit.

dh) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë, përcaktohen në kontratën e punës të lidhur midis tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 dhe 2 ku citohet se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor,

si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim

efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 2.2.1 e Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, në kriteret e veçanta të kualifikimit) si dhe kapacitetet teknike (pika 2.3.1. e Kapacitetit Teknik, në kriteret e veçanta të kualifikimit), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3 dhe nenit 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3, përcaktohet:

Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në nenin 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet:

Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Loti II : Mbikqyrje e objektit: "Rehabilitim sheshit të pallateve 39, 42/4, 43, 44, 40, rehabilitim i sheshit të pallateve 496, sistemimi i rrugës "Lirak Dodbiba", i rrugës "Gani Daiu" dhe rrugës "Mustafa Bodini", sistemimi i rrugës "Qamil Xhaja", lagjja "Syrja Dylgjeri", Rajoni nr.3" me fond limit 419.567 (katërqind e nëntëmbëdhjetemijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa t.v.sh.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteri (1- a) është vendosur në baze. bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kriteri (1-b) është vendosur bazuar në nenin 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe piken 1 të nenit 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar përcaktohet: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9;

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2026 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar; të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

Në nenin 76, pika 2 të LPP parashikohet: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia.

Në nenin 2, germa ç, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet: Ky ligj zbatohet për:

ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Në nenin 4, pika 1 dhe 3, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore.

3. Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore.

Në neni 43 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të

ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.

1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkontë regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re

Në nenin 5 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:

a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;

b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori nënkategori të bazës së taksës;

c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; si dhe ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ne nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjithatë ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Gjithashtu është kërkuar që vlera minimale e xhiros vjetore për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë, duke qenë se lloji i procedurës është e hapur e thjeshtuar, të jetë jo më vogël se 40 % e fondit limit.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatore Ekonomik duhet të paraqesin:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Në nenin 77 pika 4 i LPP, ndër të tjera parashikohet se: Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Në nenin 41, pika 3 parashikohet se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në nenin 55 “Procedura e hapur e thjeshtuar”, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të

kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Sa me siper është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale për realizimin e shërbimit, objekt i kontratës:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:

- **N.P - 1** Punime gjurmimi në tokë
- **N.P - 4** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- **N.P - 7** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.
- **N.P – 11** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- **N.P – 12** Punime të inxhinierise te mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- **N.S - 1** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 6** Sinjalistika rrugore jondriçuese
- **N.S - 7** Barriera dhe mbrojtje rrugore
- **N.S - 18** Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet ekuivalentimi i licencës profesionale që disponojne nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne VKM nr 759, date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, si dhe ne VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në piken 1 të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

*Çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të pajiset me **licencën profesionale përkatëse** dhe të regjistrohet në regjistrat profesionale të subjekteve të licencuara në këto fusha, bazuar në rregulloren bashkëlidhur këtij vendimi.*

Në nenin 2, pika 2, të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Licencë profesionale” - Është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën, të fillojë e të ushtrojë profesionalisht veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, ose mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Në nenin 16, pika 1, të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.

Ne nenin 2, pika 2 të VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, parashikohet se:

Caktimin e mbikëqyrësit/grupit të mbikëqyrësve, zhvilluesi e kryen duke pasur parasysh llojin e punimeve që do të mbikëqyren në zbatimin e veprës. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve caktohet në bazë të licencës profesionale të mbikëqyrjes që disponon dhe pikëve të kualifikimit, të cilat përkojnë me zërat e punimeve që do të kryhen në objekt.

Ne nenin 3 të VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, parashikohet se:

Në rastet kur autoritetet publike investojnë dhe realizojnë një zhvillim në një zonë të caktuar, mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve përzgjidhet nga autoriteti publik në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni për prokurimin publik në fuqi.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve qe do realizohen sipas preventivit dhe projektit te zbatimit.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit, si mëposhtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Arkitekt	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Totograf	1 (një)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesiperm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne VKM nr 759, date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, si dhe ne VKM nr.610 datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

Në nenin 16, pika 1, të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.*
- 2. Kategorive e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, përfitohen mbështetur në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale sipas kushteve dhe kriterëve të specifikuar në këtë rregullore.*
- 3. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.*

Në nenin 22, pika 2, “Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale” të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.*
- 2. Kategorive e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, përfitohen mbështetur në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale sipas kushteve dhe kriterëve të specifikuar në këtë rregullore.*
- 3. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.*

Në nenin 23, pika 2, “Kushtet paraprake për drejtuesit teknikë të shoqërisë” të VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, parashikohet se:

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim, është një, ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale në fushën respektive dhe me vite eksperience, jo më pak se 15 vjet. Individu mund të përfitojë licencën individuale, njëkohësisht, me vendosjen si drejtues teknik.

c) Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur dhe në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

ç) Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi, në dy ose më shumë shoqëri.

d) Drejtuesi/drejtuesit teknikë duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë, për një periudhë, jo më pak se një vit.

dh) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë, përcaktohen në kontratën e punës të lidhur midis tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 dhe 2 ku citohet se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor,

si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në

standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 2.2.1 e Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, në kriteret e veçanta të kualifikimit) si dhe kapacitetet teknike (pika 2.3.1. e Kapacitetit Teknik, në kriteret e veçanta të kualifikimit), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3 dhe nenit 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3, përcaktohet:

Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në nenin 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet:

Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Kudo tek specifikimet apo relacionet teknike bashkelidhur ne SPE ku janë kërkuar standartet UNI/DIN/EN/ISO do të pranohen edhe standartet SSH/ UNI/DIN/EN/ISO.

Termet e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; VKM nr.610 datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT”.

NJESIA E PROKURIMIT